



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister



01 Ref. Nr.10

Prishtinë, 28.12.2017

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 04/L-240 Për Masat Antidamping dhe masat Kundër balancuese, nenit 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 8 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

V E N D I M

1. Për marrjen e masës mbrojtëse në importe për material ndërtimor nga argjila.

1.1. Vendosjen e masës së përkohshme për 2 cent në bllok (bllokat ndarës 12x19x25) dhe Tavanore-Fert Monte (140x245x275) të materialit ndërtimor në produktet “Bllok që importohet nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës.

2. Bazuar në memorandumun shpjegues të Departamentit të Tregtisë dhe konkluzionet e dala nga takimi i Komisionit për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe i datës 29.03.2017, Dogana e Republikës së Kosovës udhëzohet që të ndërmarr të gjitha masat për mbrojtjen e prodhuesve të materialit ndërtimor me bazë nga argjila.

3. Vendimit i bashkëngjitet memo shpjeguese e përpiluar nga Komisioni dhe Departamenti i Tregtisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bajram HASANI

Ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit të MTI-së;
- Sekretares së Përgjithshme të MTI-së;
- Doganës së Republikës së Kosovës;
- Shoqatës së prodhuesve të materialit ndërtimor nga argjila SHPMN;
- Departamentit Ligjor/MTI;
- Departamentit të Tregtisë/MTI;
- Komisionit/KVDVI;
- Arkivit të MTI-së.